



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Nëntor 2024

Data 27.11.2024 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 30.10.2024 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Tetor 2024.
3. Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues me gjatësi 0.280 km rrugë kalimi në ngastra nr.98 në ekonominë pyjore Shosh 2:1.
4. Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues me gjatësi 0.659 km rrugë kalimi në ngastra nr.108 në ekonominë pyjore Gomsiqe.
- 5.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent në mbledhje.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Nëntor 2024, u zhvillua me datë 27.11.2024 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepja.Të pranishëm në sallë ishin 16 këshilltarë, (Marin Dodaj, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca,Arsen Mehmeti,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Aleko Dodani,Mirela Vasija,Sanije Salja)korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 16 vota Pro.**

Pas miratimit të rendit të ditës, bëhet prezente edhe këshilltarja Znj.Vjollcë Zagani dhe **numri total i këshilltarëve prezent bëhet 17 këshilltarë.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 30.10.2024 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 30.10.2024 nga Z.Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarëve ju spjegua se vendimet e marra në mbledhjen e muajit Tetorë, Vkb nr.79 ,është kthyer nga Institucioni i Prefektit Qarkut Shkoder për plotësim nga ana e administrates.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Tetor 2024

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Ilda Prendi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se , bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Tetor 2024, te perfitojne 137 familje, me 465.635 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Tetor 2024 janë shpallur fitues, 997 familje, me fond 7.777.092 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 466.625 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës: (Marin Dodaj, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Aleko Dodani, Mirela Vasija, Sanije Salja, Vjollcë Zagani).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues me gjatësi 0.280 km rrugë kalimi në ngastra nr.98 në ekonominë pyjore Shosh 2:1.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Aleksandër Zeka-specialist pranë zyres pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili spjegon për këshilltarët se në projekt vendimin e paraqitur, kërkohet ndertim/përdorim rruge per lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim nga Këshilli Bashkiak.

Z.Ervis Shimaj pyet:A mund të na jepni një sqarim më të hollësishem lidhur me bazen ligjore nga ku kerkohet ndertim rruge si dhe te spjegohet flora me bimesi që do të tjetersohet, lloji i pemëve pyjore që përfshin ndertimi i kësaj rruge.Gjithashtu kerkojme të dijmë se nëse është certifikuar kjo pjese që përfshin rruga, në emer te Bashkise Vau Dejes , kjo bazuar ne shkresen nr.626 prot. date 20.09.2024 e Prefektit Qarkut Shkoder?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Aleksandër Zeka përgjigjet: Hartuesit e projekt vendimit e djnë më në hollësi llojin e bimeve dhe pemëve pyjore të cilat tjetërsohen nga ndertimi i kësaj rruge dhe normalisht që kanë bërë një studim lidhur me këtë problem që ngrini, ndersa lidhur me pajisjen me çertifikatë pronësie, kemi aplikuar për tu pajisur por akoma nuk disponojmë çertifikatë pronësie.

Z.Ervis Shimaj spjeron se ne jemi të detyruar që sipas shkresës nr.626 prot. date 20.09.2024 e Prefektit Qarkut Shkoder, të shqyrtojmë vetëm projekt vendime për dhënie në përdorim të sipërfaqeve pyjore të cilat janë të çertifikuara në emër të Bashkisë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime tjera.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime të tjera..

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **16 vota kundra** (Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Aleko Dodani, Mirela Vasija, Sanije Salja, Vjollcë Zagani). **Z. Marin Dodaj nuk merr pjesë në votim. Nuk Miratohet.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues me gjatësi 0.659 km rrugë kalimi në ngastra nr.108 në ekonominë pyjore Gomsiqe.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Aleksandër Zeka-specialist pranë zyres pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se janë të njëjtat kushte si projekt vendimi i mësipërm.

Z.Ervis Shimaj bën të njëjten pyetje si per projekt vendimin e pikës 3(tre) dhe merr të njëjten përgjigje.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime tjera.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime të tjera..

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **16 vota kundra** (Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Aleko Dodani, Mirela Vasija, Sanije Salja, Vjollcë Zagani). **1 (një) votë abstenim Z. Marin Dodaj. Nuk Miratohet.**

Pika e pestë: Të ndryshme:

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë për të diskutuar probleme jashtë rendit të ditës.

Këshilltarët nuk kishin për të diskutuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës e deklaroi të mbyllur mbledhjen e datës 27.11.2024.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

Ervis Shimag
Leonovë
Neli Kopllanaj
Rita Bregu
Frano Bregu
Albina Livadli
Dorina Bregu
Prostria Shkërr
Frano Kulo
Myllëre Zogin
Ornela Lleshi
Mirela Vasija
Majlinda Wana
ALEKO DODANA
Robert Insu
Lumë Solja
Arsen Mehmeti